

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Akuzat për censurë, 'Meta' merr përgjegjësinë për pezullimin e profileve të "Flamingove": Llogaritë u mbyllën gabimisht
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/04/akuzat-per-censure-meta-merr-pergjegjesine-per-pezuilli-min-e-profileve-te-flamingove-llogarite-u-mbyllen-gabimisht/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	7 shtator 2026, 02:17:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	4 shtator 2026, 12:40:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b8e6e07f0fb8fd7c1d423e5e98788f7af9706345cbec421f74455f29a71262a8
TEKSTI	c7051b53f1a0bd4f654e24dd11b2a4512077b8ae76a923237a18cfbe0e4f1021
PAMJA	bced2e4601fe82bf77744ee9c47b2e1e4c7f4cc519b210bcfa0153e0e5141265

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d5dfcf56779e8882a3296f3165a799194f3f007067bc75e0566713f623a5c860
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a5bbc97c018d8984df054b7220126dab473ed12c408810e5715cfcc957d5e531
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmZyiYi5M8NFMB1mQj2BEQ9164NsEu9dqPV9jpDdkjuZjq



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d5dfcf56779e8882a3296f3165a799194f3f007067bc75e0566713f623a5c860>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Akuzat për censurë, 'Meta' merr përgjegjësinë për pezullimin e profileve të "Flamingove": Llogaritë u mbyllën gabimisht

Politikë

Publikuar: 04/09/2026



Meta ka pranuar se disa prej llogarive në Instagram të aktivistëve dhe mbështetësve të "Revolucionit të Flamingove" janë mbyllur gabimisht, duke rrëzuar tezën se pas pezullimeve qëndronte përpjekja e qeverisë shqiptare për të censuruar këto llogari.

Kompania ka bërë të ditur se po rishikon masat e marra ndaj profileve të prekura dhe se disa prej tyre tashmë janë rikthyer.

Pranimi vjen pas disa ditësh akuzash të forta nga aktivistë dhe figura të opozitës, të cilët e paraqitën mbylljen e profileve si një operacion politik të orkestruar nga qeveria për të censuruar protestën.

Por deri tani nuk është paraqitur asnjë provë që e lidh qeverinë shqiptare me pezullimet, ndërsa vetë Meta po pranon se të paktën një pjesë e tyre kanë ardhur nga vendime të gabuara të platformës.

Kompania nuk ka sqaruar ende sa llogari janë prekur dhe as nëse gabimi është shkaktuar nga sistemet automatike të moderimit apo nga raportime masive të përdoruesve. Megjithatë, Meta është përballur edhe më herët me kritika të shumta për pezullime dhe mbyllje të gabuara llogarish, si rezultat i përdorimit të sistemeve automatike të moderimit dhe përdorimit të inteligjencës artificiale. Në fakt, muajt e fundit, mijëra përdorues të Facebook dhe Instagram në të gjithë botën kanë raportuar bllokime të padrejta për shkelje që nuk i kishin kryer, ndërsa në disa raste llogaritë janë rikthyer vetëm pas ankesave publike ose ndërhyrjes së medias.

Akuzat për bllokimin e llogarive në Shqipëri morën jehonë edhe

Me të lexuarat "Kemi dasmë!"

/ Deklarata e Eneda Tarifës në qendër të polemikave në rrjet, këngëtarja shqiptare kapet mat gjykatave: ...

Burg për security-t e Luan Muçës, "liri" nga qelia për qitësin e vashit të asili

fsheh pasuri qindra mijëra euro te Kodra e Diellit dhe pallat në emrin e gruas së d...

'Agjenti 007' i Sarandës i infiltruar në operacionin me 25 të arrestuar. Një tjetër version

sjellë paratë e kokainës në Shqipëri përmes sistemit Hawala. Pse Edmond Leka është ...

jashtë vendit, ku përraqesues të Partisë Demokratike Europiane kërkuar sqarime dhe ngritën shqetësime për pluralizmin politik dhe lirinë e shprehjes.

Kryeministri Edi Rama i hodhi poshtë këto pretendime, duke deklaruar se qeveria shqiptare nuk kishte asnjë rol në pezullimin e profileve dhe as mundësi teknike për të ndërhyrë në vendimmarrjen e platformave sociale.

Pranimi i Meta-s nuk sqaron ende të gjithë mekanizmin që çoi te mbyllja e profileve, por rrëzon pretendimin se ekzistonte tashmë një provë për censurë të organizuar nga qeveria. Për momentin, ajo që është konfirmuar është shumë më prozaike: Meta ka bërë gabime në moderim.

TAG:

instagram

Meta

Pezullimi i profileve

Të ngjashme



Berisha takim me militantët në SHBA, sulmon Blinken dhe Yuri Kim: Kush na tregoi barin, sot është pa punë! Ata që më shpallën 'non grata', janë të ...



"Pushteti është një kafshë e përbindshme" - Rama për Ilir Metën: E futi nën vete dhe e katandisi në personazh qesharak



Pagat e gjyqtarëve, Rama: Secili institucion në vendin e vet! Vendimin e merr Parlamenti

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuar me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË

KRYESORE POLITIKË EKONOMI

ANALIZË RAJON KULTURË SPORT



Email:

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)